



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS SË PEJËS

I.Numër: 016/01-16755 , dt. 31 Mars 2026.

Në bazë të nenit 11 e nenit 12.2 pika d) dhe nenit 25.2 të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28.datë: 04.qershor 2008”), nenit 5. paragrafi 2. të Ligjit për Ndërmarrjet Publike të Republikës së Kosovës Nr.03/L – 087 datë: 13 qershor 2008, nenit 20, paragrafi 1 pika 1.4. të Statutit Nr.01/2020 të Komunës së Pejës, I.Numër:01-016/01-413431 dt. 30. Shtator 2020, Kuvendi Komunal Pejë, në takimin e mbajtur me datë: 31 Mars 2026, merr:

VENDIM

Nr.18/2026

**mbi zëvendësimin e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L.
“AMBIENTI” SH.A. PEJË**

1. Me këtë vendim bëhet zëvendësimi i anëtarit të Komisioni Komunal i Aksionarëve për ushtrimin e të drejtës aksionare të Komunës së Pejës, në N.P.L. “AMBIENTI” sh.a. me seli në Pejë, si vijon:
 - 1.1. Anëtari i kuvendit z. Leotrim Murtezaj, nga subjekti politikë PDK, emërohet anëtarë i KKA. në N.P.L.”Ambienti” sh.a. me seli në Pejë, në vend të anëtarit të dorëhequr nga pozita e anëtarit të kuvendit z. Albi Shala, nga i njejtë subjekt politik.
2. Anëtari i Komisioni nga pika 1 e këtij Vendimi do të ushtrojë të drejtën e Komunës së Pejës, si aksionarë në N.P.L. “Ambienti” sh.a. me seli në Pejë, konform nenit 5. paragrafi 2 të Ligjit Nr.03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike, si dhe duhet të veproi në përputhje me Ligjin Nr. 06/L -016 për Shoqëritë Tregtare.
3. Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Pejës.
4. Me këtë vendim bëhet ndryshimi i pikës 1, paragrafi 1.3. i Vendimi Nr. 06-2026 mbi themelimin e Komisionit Komunal të Aksionarëve të N.P.L. “AMBIENTI” SH.A. PEJË, me nr. protokollit: 016/01-8781, dt.26 Shkurt 2026.
5. Ky vendim shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhë zyrtare në web-faqen e Komunës së Pejës.

Vendimi i dërgohet:

MAPL,

Kryetarit të Komunës,

DPKSHP dhe anëtareve të zgjedhur, Arkivë.

